



SYLLABUS I LËNDËS “BIOLOGJIA E SHTAZËVE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
Titulli i lëndës:	Biologjia e shtazëve
Programi:	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (SHPM)
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i pare, semestri i pare
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Do të përcaktohet
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Albana Plakiqi Milaimi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: +383/44 187 368 E-mail: albana.milaimi@umi-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Studentët do të njoftohen me biologjinë qelizore: Qelizën, Strukturën dhe funksionin e kompartimenteve brendaqelizore; metabolizmin qelizor, si dhe metodat eksperimentuese në biologjinë qelizore. Ata, do të mësojnë dhe të dallojnë qelizat eukariote dhe prokariote (organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë). Poashtu, do të njohin strukturën dhe funksionin e indeve shtazore; strukturën dhe shumëllojshmërinë e kafshëve: Morfologjinë dhe fiziologjinë e sistemeve të organeve të kafshëve me theks të veçantë të organizmave model; riprodhimin dhe zhvillimin e tyre. Studentëve do t'i ofrohet mundësia të kuptojnë ndërveprimin midis kafshëve dhe mjedisit të tyre; ndryshimet e mjedisit dhe ekosistemin në përgjithsi, si dhe krahasimin e faktorëve mjedisorë ekologjikë. Gjithashtu, ata do të mësojnë karakteristikat morfologjike, biologjike dhe ekologjike të shtazëve më të rëndësishme dhe tipike të taksoneve të pyjeve tona, siç janë: Nematoda, Arachnida, Myriopoda, Insecta, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mammalia; Sistematikën dhe determinimin e insekteve, veçanërisht insekteve fitofage-dëmtuese të pyjeve Kosovare, si dhe dinamikën e populacioneve.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohja e proceseve biologjike themelore nga niveli qelizor e deri në nivel të organizmit shtazor; Njohja e morfologjisë, bionomisë, etologjisë dhe ekologjisë së shtazëve pyjore dhe rëndësinë e tyre për drunjtë dhe pyjet.</p>
Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none">• Diskutojnë ndërtimin dhe funksionin e strukturave qelizore.• Njohin shumëllojshmërinë, morfologjinë anatomike dhe fiziologjinë e organizmave shtazorë.• Theksojnë parimet bazë të aspekteve biologjike dhe ekologjike të shtazëve më të rëndësishme dhe tipike të pyjeve.• Analizojnë dhe krahasojnë rëndësinë e organizmave shtazor në funksion të ambientit dhe anasjelltas.• Të zbatojnë njohuritë teorike në praktike.



Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5/semestër	-	5
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	4/semestër	-	4
Detyra të shtëpisë	6/semestër	-	6
Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	6/semestër	-	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	4/semestër	-	4
Projektet, prezantimet ,etj	5/semestër	-	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vlerësimi i dytë 15 %, Vijimi i rregullt: 5 %, Provimi final: 55%, Total: 100%.		
Mjetet e konkretizimit	Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.		
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	1.5:1 (3+2 orë).		
Literatura			
Literatura primare:	1. Kasum Letaj, Albana Milaimi 2018. Biologjia e shtazëve. Skriptë me përmbjedhje ligjëratah. 2. Isa Elezaj, Kasum Letaj. Biologjia qelizore. Universiteti i Prishtinës, 2012, Prishtinë. 3. Rexha, T. Biologjia qelizore dhe molekulare; Shtëpia botuese “Mediaprint”, 2012, Tiranë.		
Literatura shtesë:	4. Dervish Rozhaja. Fiziologjia krahasuese. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2002, Prishtinë. 5. Ruppert, E.E., Barnes, D.R., 1996. Invertebarate zoology. Sixth edition. Saunders College Publishing.		

Plani i dizajnuar i mësimi:



Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Qeliza - Karakteristikat e përgjithshme të saj; Metodat në biologjinë qelizore; struktura dhe funksioni i qelizave prokaryote dhe eukariote.	Mikroskopi dhe metodat e mikroskopimit.
<i>Java e dytë:</i>	Membrane qelizore; Përbërja kimike dhe transporti membranor.	Ndërtimi i qelizës prokariote.
<i>Java e tretë:</i>	Organelet brendaqelizore dhe funksioni i tyre; Citoskeleti.	Ndërtimi i qelizës eukariote; kultura e parameciumit.
<i>Java e katërt:</i>	Cikli qelizor dhe kontrolli i tij; sinjalizimi qelizor.	Mitoza dhe mejoza.
<i>Java e pestë:</i>	Struktura dhe funksioni i indeve shtazore.	Indi epitelial dhe lidhor
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemi i organeve të tretjes, të qarkullimit të gjakut dhe frymëmarrjes.	Indi muskolor dhe Nervor
<i>Java e shtatë:</i>	Sistemi i organeve për sekretim dhe atij të lëvizjes. Vlerësimi i parë intermerdier	Ventilacioni i mushkërive.
<i>Java e tetë:</i>	Sistemi nervor dhe sistemi i organeve shqisore.	Sistemi i qarkullimit të gjakut të bretkosa.
<i>Java e nëntë:</i>	Sistemi endokrin dhe sistemi imun	Grupet e gjakut.
<i>Java e dhjetë:</i>	Reprodukimi dhe zhvillimi embrional i shtazëve.	Sistemet e organeve të brendshme të bretkosa.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ekologjia e përgjithshme; Ndryshimet e mjedisit dhe ekosistemi.	Gametogjeneza (Spermatogjeneza dhe oogjeneza).
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Nematodat dhe Arachnidat.	Zhvillimi embrional i amfibeve dhe shpendëve.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Myriapoda dhe insecta; Sistematika dhe determinimi i insekteve fitofage të pyjeve të Kosovës.	Vrojtimi dhe determinimi i krimbave parazitë.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Amphibia dhe Reptilia.	Vrojtimi dhe determinimi i kurrizorëve të pranishëm në pyjet e Kosovës.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Aves dhe Mammalia. Vlerësimi i dytë intermerdier	Vrojtimi, mbledhja dhe determinimi i insekteve fitofage.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		



Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe në punë seminarike;
Mbajtja e qetësisë në mësim, çkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj.